



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta	
Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref.Nr.	3305/2021
Data	20.09.2021
Datum	
Date	
Nënshkrimi	
Edits	
Signature	
PRISHTINE, PRISTINA, PRISHTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
MINISTRIA E KULTURËS,RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS

ZYRA PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA

Thirrja publike për palët e interesuara për hartimin dhe publikimin e artikujve me përmbajtje shkencore e profesionale nga fusha e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqëruara që do të jenë pjesë e numrit të radhës së revistës vjetore "Autori", të cilën e nxjerrë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përkatësisht Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta me qëllim të promovimit dhe forcimit të respektit për të drejtat pronësore intelektuale, përkatësisht të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqëruara është në proces të nxjerrjes përkatësisht botimit të numrit të VII - të revistës së përvjetshme "Autori".

Kjo revistë, ka shërbyer si burim i rëndësishëm i informacionit për zhvillimet e reja rreth fushës së krijimtarisë në përgjithësi e cila mbrohet me të drejtën e autorit, duke qenë një ndër burimet e pakta të literaturës në fushën e pronësisë intelektuale, veçanërisht drejtës së autorit, në gjuhën shqipe.

Andaj, ZDA, përmes kësaj thirrje publike i fton palët e interesuara që kanë njohuri për fushën e të drejtës së pronësisë intelektuale, të bëhen pjesë e numrit të kësaj reviste, duke përgatitur dhe dorëzuar në MKRS artikuj që përkojnë me fushën e pronësisë intelektuale, përkatësisht të drejtën e autorit.

2. Kërkesat e përgjithshme:

- 2.1. Artikulli për revistën "Autori", duhet të jetë punë origjinale,
- 2.2. E pa botuar më herët në ndonjë revistë tjetër;
- 2.3. Të ketë dy deri tri faqe word,
- 2.4. Të përmbajë ndonjë fotografi përshkruese të artikullit.

3. Në mënyrë të veçantë inkurajohen që të aplikojnë:
 - 3.1. Përfaqësuesit e institucioneve që janë të përfaqësuara në Task - Forcën Kundër Piraterisë;
 - 3.2. Personalitete me përvojë në sistemin e drejtësisë;
 - 3.3. Avokatë dhe apo konsulentë ligjor;
 - 3.4. Personalitete nga bota akademike dhe e stafit akademik në institucionet e arsimit të lartë dhe të akredituara në Republikën e Kosovës;
 - 3.5. Gazetarë;
 - 3.6. Krijues;
 - 3.7. Studentë;
 - 3.8. Personalitete me njohuri përkatëse për fushën.
4. Artikujt që vlerësohen dhe përzgjedhen nga Komisioni, publikohen në cilësi personale të autorit.
5. Artikujt e përzgjedhur do të kompensohen financiarisht.
6. Data e fundit për pranimin e artikujve është 15.10.2021;
7. Forma e dorëzimit të artikujve së bashku me një përshkrim të shkurtër të biografisë së autorit mund të bëhet në njërin nga format si më poshtë:
 - 7.1. Përmes dorëzimit të dokumentacionit në zyrën e pranimit të dokumenteve - Zyra e Arkivit/ MKRS me numër 022;
 - 7.2. Në mënyrë elektronike në njërin nga e -maillet e mëposhtme:
 - 7.2.1. donjeta.bytyci@rks-gov.net;
 - 7.2.2. zjarrta.osmani@rks-gov.net
8. Për përzgjedhjen e këtyre artikujve do të formohet një komisionin, i cili do t'i vlerësojë dhe përzgjedh artikujt të cilët do të botohen.

Prishtinë, 20/09/2021